

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR

“KUZHINË”

Kodi: PK-G-3-24

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2024

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“KUZHINË”

(PK-G-3-24)

I. Profili Profesional i kuzhinierit

a) Karakteristikat e kuzhinierit

Kuzhinieri është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në sektorin e gastronomisë.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, kuzhinieri duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehi** praktike që lidhen me veprimtarinë profesionale të kuzhinierit.

Suksesi i kuzhinierit është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, saktësia, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e kuzhinierit

Profesioni i kuzhinierit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për gatimin e buljoneve, suprave, sallatave, antipastave, brumrave, vezëve, asortimenteve me mish, peshk dhe prodhime deti dhe me perime. Ai mund të punësohet ose vetëpunësohet në kuzhina të hoteleve, restoranteve, mencave, kroçerave, në industrinë e kateringut, bistro-ve, fast food-eve dhe të institucioneve dhe ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e kuzhinës.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e kuzhinierit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, kuzhinieri mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si kuzhinier i kualifikuar. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e teknologut ushqimor.

Për të zhvilluar aktivitet privat dhe për vetëpunësim, në veprimtarinë e kuzhinës duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Ndihmës kuzhinier”, me kod 9412, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Kuzhinë”

Në përfundim të kursit për kuzhinë, kursantët do të jenë të aftë të:

- kryejnë organizimin e punës në repartin e kuzhinës.
- përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik dhe financiar në kuzhinë.
- hartojnë dhe zbërthejnë planin e prodhimit.
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet dhe materialet e duhura të punës.
- mirëmbajnë mjetet, materialet e pajisjet dhe i inventarizojnë ato në mjedisin e punës.
- kryejnë procese parapërgatitore në kuzhinë.
- hartojnë fletë-kërkesën për lëndë të para dhe ndihmëse, në zbatim të planit të prodhimit dhe recetës.
- përgatitin buljone dhe supa.
- përgatitin salca të nxehta dhe të ftohta.
- përgatitin sallatat dhe antipastat.
- përgatisin asortimente me oriz dhe rizoto.
- përgatisin ushqime të vogla (finger food) për pritje dhe bankete.

- përgatisin vezë të llojeve të ndryshme.
- përgatitin asortimente me mish.
- përgatisin asortimente me peshk dhe prodhime deti.
- përgatisin bukë të vogla, brumra të llojeve të ndryshme si dhe asortimente me të.
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë, të higjienës, të ruajtjes së mjedisit dhe dhënies së ndihmës së parë, sipas standardit ISO/HACCP.
- zbatojnë standardet e profesionit.
- zbatojnë rregullat e estetikës në gatim.
- zbatojnë standardet e garantimit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.
- zbatojnë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit.
- komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Kuzhinë”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Kuzhinë” duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyrues.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Kuzhinë”

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Kuzhinë”

Nr	Titulli i Modullit	Ko di	Kohëzgjatja	Rezultatet e të nxënit
1	Hyrje në profesionin e kuzhinierit	MK-13-102-24	24 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kuzhinierit. 2. Kursanti përshkruan rregullat e higjienës, veshjes së uniformës profesionale dhe të mbrojtjes në punë. 3. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, pajisjet e punës dhe detergjentet që përdoren në kuzhinë.
2	Përgatitja e buljoneve, supave dhe salcave	MK-13-103-24	48 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit buljone. 2. Kursanti përgatit supa. 3. Kursanti përgatit salca të nxehta. 4. Kursanti përgatit salca të ftohta.
3	Përgatitja e sallatave, antipastave, asortimenteve me perime, si dhe vezëve	MK-13-104-24	48 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit sallata. 2. Kursanti përgatit antipasta. 3. Kursanti përgatit asortimente me perime. 4. Kursanti përgatit vezë të ndryshme. 5. Kursanti përgatit ushqime të vogla (finger food) për pritje dhe bankete

4	Përgatitja e asortimenteve me mish dhe shpendë	MK-13-105-24	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit asortimente me mish dhe shpendë. 2. Kursanti përgatit prodhime gjysmë të gatshme me mish dhe shpendë, si dhe të brendshmet e tyre. 3. Kursanti përgatit asortimente me të brendshme mishi/ shpendë. 4. Kursanti përgatit asortimente me mish të grirë.
5	Përgatitja e asortimenteve me peshk dhe prodhime deti	MK-13-106-24	68 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit asortimente me peshk. 2. Kursanti përgatit asortimente me prodhime deti.
6	Përgatitja e brumrave dhe asortimenteve me to	MK-13-107-24	72 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit brumin me maja dhe asortimente me të. 2. Kursanti përgatit brumin për makarona dhe asortimente me të. 3. Kursanti përgatit brumin dhe asortimente me brumin e byrekut. 4. Kursanti përgatit brumin pandispanjë dhe asortimente me të. 5. Kursanti përgatit brumin e shkrifët (brisé). 6. Kursanti përgatit brumin e zier shù. 7. Kursanti përgatit brumë të hollë (petë tigani). 8. Kursanti përgatit brumin suflé. 9. Kursanti përgatit njoki. 10. Kursanti përgatit asortimente me oriz dhe rizoto. 11. Kursanti përgatit asortimente me miell misri. 12. Kursanti përgatit bukë të vogla dhe asortimente brumi për shërbim në restorant.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MEKI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Kuzhinë:

1. Moduli "Hyrje ne profesionin e kuzhinierit"

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E KUZHINIERIT	MK-13-102-24
Qëllimi i modulit	Një modul që njeh kursantët me veçoritë e profesionit të kuzhinierit, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e tij me mjedisin, mjetet dhe pajisjet e punës, veshjes së uniformës, zbatimin e rregullave të sigurisë, mbrojtjes në punë, dhënies së ndihmës së parë dhe të ruajtjes së mjedisit, leximit dhe interpretimit të dokumentacionit teknik dhe financiar.	
Kohëzgjatja e modulit	24 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kuzhinierit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë rëndësinë ekonomike dhe sociale të industrisë së mikpritjes; – të përshkruajë llojet e strukturave të industrisë së mikpritjes; – të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës në kuzhinë; – të përshkruajë kërkesat profesionale për punonjësit e kuzhinës; – të përshkruajë rëndësinë e komunikim etik dhe profesional në vendin e punës; – të tregojë mundësitë e punësimit të kuzhinierit; – të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të punjonjësit të kuzhinës; – të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike dhe profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët; – të tregojë rëndësinë e zbatimit të detyrave në kuzhinë; – të përshkruajë rregullat për garantimin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore (ISO/HACCP); – të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në industrinë e mikpritjes dhe Kodit të Punës. Instrumentet e vlerësimit: – Pyetje përgjigje me gojë. – Pyetje - përgjigje me shkrim. RN 2 Kursanti përshkruan rregullat e higjienës, veshjes së uniformës profesionale dhe të mbrojtjes në punë.	

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të dallojë pjesët përbërëse të uniformës profesionale të kuzhinierit;
- të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik në kuzhinë;
- të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, ndarjes së mbeturinave sipas llojit dhe grumbullimit të vajit të përdorur për riciklim;
- të përshkruajë rregullat për dhënien ndihmës së parë në rastet e rrëshqitjeve në kuzhinë;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e prerjeve në kuzhinë;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e dëmtimeve nga thyerja e enëve prej qelqi dhe porcelain;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e dëmtimeve nga përdorimi i makinerive në kuzhinë;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e dëmtimeve nga detergjentët dhe desinfektantët në kuzhinë;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e dëmtimeve nga djegiet në kuzhinë;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në raste asfiksie;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në raste epilepsie;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në raste goditje elektrike;
- të përshkruajë rregullat për dhënien e ndihmës së parë në raste frakturash;
- të përshkruajë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë dhënies së ndihmës së parë në kuzhinë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RN 3 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet, pajisjet e punës dhe detergjentet që përdoren në kuzhinë.**Kriteret e vlerësimit:**

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës në kuzhinë;
- të përshkruajë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e punës në grup në kuzhinë;
- të përshkruajë domosdoshmërinë e koordinimit të veprimtarive me kolegët dhe vartësit;

- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdoren në kuzhinë;
- të përshkruajë sektorët e punës në kuzhinë;
- të përshkruajë dokumentacionin teknik dhe financiar që përdoret në kuzhinë;
- të përshkruajë rëndësinë e hartimit të plan prodhimit në kuzhinë;
- të përshkruajë rëndësinë e hartimit të fletë-kërkesës në kuzhinë;
- të shpjegojë konceptin menu, recetë dhe recepturë në kuzhinë;
- të shpjegojë kuptimin mbi firot dhe rëndësinë e llogaritjes së tyre;
- të tregojë llojet e detergjentëve dhe dezifektuesve që përdoren në kuzhinë (Standarti 3D);
- të tregojë rëndësinë e kujdesit gjatë përdorimit të detergjentëve dhe dezifektuesve gjatë përdorimit në kuzhinë;
- të tregojë mënyrat e ruajtjes së detergjentëve dhe dezifektuesve në kuzhinë;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përdorimit të detergjentëve dhe dezifektuesve në kuzhinë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të kuzhinës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e kuzhinës. Atyre duhet ti jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të kuzhinierit, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e kuzhinierit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës në repart kuzhinë.

-
- Komplet i materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të punës për gatim.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara, menu, plane prodhimi, fletë-kërkesë, receta dhe menu në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Përgatitja e buljoneve, supave dhe salcave”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E BULJONEVE, SUPAVE DHE SALCAVE.	MK-13-103-24
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për të përgatitur buljone, supa, salca të nxehta dhe salca të ftohta.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e kuzhinierit”.	
Rezultatet e të nxënies (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përgatit buljone. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të buljoneve në kuzhinë. – të tregojë llojet e buljoneve. – të veshë uniformën profesionale në vendin e punës. – të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë. – të hartojë planin e prodhimit dhe fletë-kërkesën për lëndë të para dhe ndihmëse. – të parapërgatitë vendin e punës për gatimin e buljoneve. – të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për përgatitjen e buljoneve. – të lexojë saktë recetën. – të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e buljoneve. – të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse. – të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës. – të kryejë procese parapërgatitore për gatimin e buljoneve (peshim, larje, qërim, prerje, coptim). – të kryejë etapat e e procesit teknologjik termik, për gatimin e buljoneve (vlim, heqje e shkumës, shtim i përbërësve të tjerë, kullim). – të mbikqyrë procesin teknologjik të përgatitjes së buljoneve. – të kryejë vlerësimin organo-shqisor të buljoneve të përgatitura. – të prezantojë buljonet, sipas rregullave të estetikës. – të llogarisë koston e buljonit të përgatitur. – të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të buljoneve për ruajtje. – të zbatojë kushtet e ruajtjes së buljoneve. – të pastrojë, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.	

- të kryejë inventarizimin e mjeteve të punës, si dhe të lëndëve të para për ruajtje në kuzhinë.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së buljoneve në kuzhinë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti përgatit supa.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të buljoneve për përgatitjet e supës në kuzhinë.
- të dallojë llojet e supave.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të hartojë planin e prodhimit.
- të parapërgatitë vendin e punës për gatimin e supave.
- të lexojë saktë recetën.
- të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e supave.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recetës.
- të kryejë procese parapërgatitore për gatimin e supave
- (peshim, larje, qërim, prerje, coptim, grimcim).
- të kryejë etapat e e procesit teknologjik termik, për gatimin e supave (zierje, shtimi i përbërësve të tjerë).
- të mbikqyrë procesin e zierjes dhe kremëzimit të supës.
- të përgatitë supa tipike shqiptare sipas krahinave.
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të supave të përgatitura.
- të prezantojë suprat, sipas rregullave të estetikës.
- të llogarisë koston e supës së përgatitur.
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
- të inventarizojë mjetet e punës dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së supave në kuzhinë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përgatit salca të nxehta.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të salcave të nxehta në kuzhinë.
- të dallojë llojet e salcave të nxehta.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të hartojë planin e prodhimit.
- të parapërgatitë vendin e punës për gatimin e salcave të nxehta.
- të lexojë saktë recetën.
- të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e salcave të nxehta.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recetës.
- të kryejë përpunimin e ftohtë të lëndëve të para dhe ndihmëse, për përgatitjen e salcave të nxehta sipas recetës;
- të përgatisë salcat e nxehta sipas recetës (salca e errët bazë, salca beshamel, salca demiglass, salcë e bardhë bazë, salcë ekstrakt e mishrave të pjekur, salcë hollandeze etj.).
- të kryejë etapat e e procesit teknologjik termik për përgatitjen e salcave të nxehta.
- të kryejë procesin e lidhjes së salcave (me roux, reduktim, xhelatinë etj.).
- të mbikqyrë procesin teknologjik të përgatitjes së salcave të nxehta.
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të salcave të përgatitura.
- të prezantojë salcat, sipas rregullave të estetikës, në enë të përshtatshme.
- të zbatojë teknikat dhe kushtet e ruajtjes së salcave të nxehta sipas llojit;
- të llogarisë koston e salcës së përgatitur.
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
- të inventarizojë mjetet e punës dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së salcave të nxehta në kuzhinë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti përgatit salca të ftohta.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të salcave të ftohta në kuzhinë.

- të dallojë llojet e salcave të ftohta.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të hartojë planin e prodhimit.
- të parapërgatitë vendin e punës për përgatitjen e salcave të ftohta.
- të lexojë saktë recetën.
- të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e salcave të ftohta.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recetës.
- të kryejë përpunimin e ftohtë të lëndëve të para dhe ndihmëse për përgatitjen e salcave të ftohta sipas recetës;
- të përgatisë salcat e ftohta sipas recetës (salcat e gjelbërta, gjalpi i përpunuar me erëza, djathrat e përpunuar, etj.).
- të kryejë etapat e e procesit teknologjik për përgatitjen e salcave të ftohta.
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të salcave të përgatitura.
- të prezantojë salcat, sipas rregullave të estetikës, në enë të përshtatshme.
- të llogarisë koston e salcës së përgatitur.
- të zbatojë teknikat e ruajtjes së salcave të ftohta sipas llojit;
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
- të inventarizojë mjetet e punës dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së salcave të ftohta në kuzhinë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të kuzhinës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e kuzhinës. Atyre duhet ti jepen detyra të gatujnë buljone, supa dhe salca. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.

-
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
-

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në repart kuzhine.
 - Kompleti i materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të punës për gatimin e buljoneve, supave dhe salcave të nxehta dhe të ftohta.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara, menu, plane prodhimi, receta, në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Përgatitja e sallatave, antipastave, asortimenteve me perime, si dhe vezëve.”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E SALLATAVE, ANTIPASTAVE, ASORTIMENTEVE ME PERIME, SI DHE VEZËVE.	MK-13-104-24
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për të përgatitur sallata, antipasta, vezë dhe asortimente me perime në kuzhinë.	
Kohëzgjatja e modulit	48 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e kuzhinierit”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përgatit sallata. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për përgatitjen e sallatave. – të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit cilësor të lëndëve të para dhe ndihmëse, që përdoren për sallatë. – të dallojë salcat që përdoren për dressing të sallatave. – të shpjegojë rëndësinë e procesit të marinimit të lëndëve të para dhe ndihmëse. – të veshë uniformën profesionale në vendin e punës. – të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë; – të hartojë planin e prodhimit dhe fletë-kërkesën. – të parapërgatitë vendin e punës për përgatitjen e sallatave. – të lexojë saktë recetën. – të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e sallatave. – të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse. – të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës. – të kryejë procese parapërgatitore për përgatitjen e sallatave sipas recetës (peshim, larje, qërim, heqje bisqesh, farash, prerje, coptim, grimcim, marinim, zierje, pjekje etj.). – të përgatitë dekoruesit (shtesat) për sallata të ndryshme. – të hedhë sasi të erëzave sipas llojit të sallatës. – të përgatitë dressing për sallata sipas recetës. – të erëzojë dhe dekorojë sallatat. – të mbikqyrë procesin teknologjik të përgatitjes së sallatës. – të prezantojë sallatat, sipas rregullave të estetikës. – të bëjë vlerësimin organo-shqisor të sallatës. – të llogarisë koston e sallatës së përgatitur.	

-
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standartit.
 - të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
 - të inventarizojë mjetet e punës dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
 - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së sallatave në kuzhinë.
 - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti përgatit antipasta.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të dallojë lëndët e para dhe ndihmëse që përdoren për përgatitjen e antipastave.
- të përshkruajë karakteristikat e antipastave.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të hartojë planin e prodhimit dhe fletë-kërkesën.
- të parapërgatitë vendin e punës për përgatitjen e antipastave.
- të lexojë saktë recetën.
- të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e antipastave.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recetës.
- të kryejë procese parapërgatitore të lëndëve të para dhe ndihmëse për përgatitjen antipastave (peshim, larje, qërim, heqje bisqesh, farash, prerje, coptim, grimcim, marinim, zierje, pjekje, skuqje, racionim etj.).
- të përgatitë dekoruesit (shtesat) për antipasta të ndryshme.
- të hedhë sasitë e erëzave sipas llojit antipastës.
- të përgatitë dressing/salca për antipastat.
- të mbikqyrë procesin teknologjik të përgatitjes së antipastave.
- të përgatitë antipasta shqiptare sipas krahinave.
- të prezantojë antipastat, sipas rregullave të estetikës.
- të bëjë vlerësimin organo-shqisor të antipastës.
- të llogarisë koston e antipastave të përgatitura.
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para, ndihmëse dhe prodhimeve të parapërgatitura për antipastat në kuzhinë.
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.

- të inventarizojë mjetet e punës dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së antipastave në kuzhinë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përgatit asortimente me perime.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë vlerat ushqimore të perimeve.
- të përshkruajë rëndësinë e vlerësimit organo-shqisor të perimeve.
- të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së vlerave ushqimore të perimeve gjatë përpunimit.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të hartojë planin e prodhimit dhe fletë-kërkesën.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse.
- të parapërgatitë vendin e punës për përgatitjen e asortimenteve me perime.
- të lexojë saktë recetën.
- të përzgjedhë mjetet e duhura të punës për përgatitjen e asortimenteve me perime.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recetës.
- të kryejë procese parapërgatitore për gatimin e asortimenteve me perime (peshim, larje, qërim, prerje, heqje bisqesh, farash, prerje, coptim, zierje, pjekje etj.).
- të hedhë sasi të duhura të erëzave sipas asortimentit.
- të mbikqyrë procesin teknologjik të gatimit të asortimenteve me perime.
- të përgatitë asortimente me perime, tipike shqiptare sipas krahinave
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të asortimentit me perime.
- të dekorojë dhe prezantojë asortimentin e përgatitur.
- të llogarisë koston e asortimenteve të përgatitura.
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standartit.
- të inventarizojë mjetet e punës si dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë procedurat për grumbullimin e yndyrnave të përdorura për riciklim.
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.

- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti përgatit vezë të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të freskisë së vezës.
- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kushteve të ruajtjes së vezëve.
- të shpjegojë rëndësinë e pasterizimit të vezëve në kuzhinë.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të parapërgatitë vendin e punës për gatimin e vezëve sipas recetës.
- të përzgjedhë mjetet e punës për gatimin e vezëve.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse, sipas fletë-kërkesës.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës.
- të kryejë procese parapërgatitore për gatimin e vezëve, (mat, peshon, pastron, lan, pret, grimcon, kontrollojnë freskinë etj.)
- të përgatisë vezët (me zierje, skuqje, pjekje në furrë dhe skarë etj.).
- të mbikqyrë procesin teknologjik të përgatitjes së vezëve.
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të vezëve të përgatitura.
- të konstatojë defektet e mundshme gjatë përgatitjes së vezëve.
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse në kuzhinë sipas standardit.
- të llogarisë koston e vezëve të përgatitura.
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
- të inventarizojë mjetet e punës si dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së vezëve në kuzhinë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Kursanti përgatit ushqime të vogla (finger food) për pritje dhe bankete.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të planifikojë veprimtaritë e ushqimeve të pritjeve dhe banketeve
- të vesh uniformën dhe të kujdeset për higjenën personale
- të përzgjedhë lëndet e para sipas llojit të menisë për bankete dhe
- të planifikojë dhe hartojë list-kërkesën për lëndën e parë dhe ndihmëse
- të interpretojë planin e prodhimit sipas llojit të menisë si dhe llogaritjen e sasive të lëndëve të para
- të shpjegojë procesin e parapërgatitjes së asortimenteve të duhura
- të përzgjedhë mjetet e punës dhe të kryejë proceset si (pastrim, larje, prerje, peshim, marinim, zjerje, pjekje etj..)
- të realizojë procesin teknologjik (termik) sipas llojit të menisë të banketit
- të zbatojë kushtet e ruajtjes së lëndëve të para
- të sistemojë ushqimet e përgatitura sipas rregullave
- të përgatisë dekoruesit sipas rregullave të estetikës, të kombinojë ngjyrat dhe shijet
- të pastroj vendin e punës, të sistemojë mjetet dhe pajisjet e kuzhinës
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në ambjentet e kuzhinës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të kuzhinës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e kuzhinës. Atyre duhet t'i jepen detyra për të gatuar sallata, antipasta, asortimente me perime dhe vezë të ndryshme. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:



**e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në repart kuzhine për gatimin e sallatave, antipastave, asortimenteve me perime dhe vezëve të ndryshme.
 - Komplet i mjeteve dhe pajisjeve të punës në kuzhinë, për gatimin e sallatave, antipastave, asortimentev me perime dhe vezëve.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara, receta në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Përgatitja e asortimenteve me mish dhe shpendë”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E ASORTIMENTEVE ME MISH DHE SHPENDË	MK-13-105-24
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantet për të përgatitur asortimente me mish dhe shpendë, prodhime gjysmë të gatshme me mish e shpendë e të brendshmet e tyre, asortimente me të brendshmet, si dhe asortimente me mish të grirë.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e kuzhinierit”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përgatit asortimente me mish dhe shpendë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: – të dallojë llojet e bagëtive dhe shpendëve. – të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit organo-shqisur të mishit të bagëtive dhe mishit të shpendëve. – të dallojë ndarjen e mishit në pjesë dhe cilësi. – të emërtojë pjesët e filetës sipas ndarjes anatomike. – të emërtojë gjysëmprodhimet që merren nga secila cilësi. – të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kushteve të ruajtjes dhe shkrijës së mishit. – të shpjegojë rëndësinë e etiketimit të mishit për ruajtje. – të përshkruajë rëndësinë e marinimit të mishit dhe shpendëve, sipas llojit. – të veshë uniformën profesionale në vendin e punës. – të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë; – të hartojë planin e prodhimit dhe fletë-kërkesën. – të parapërgatitë vendin e punës për gatimin e asortimenteve me mish dhe shpendë. – të lexojë saktë recetën. – të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e gatimit e asortimenteve me mish dhe shpendë. – të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse. – të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës. – të kryejë procese parapërgatitore për gatimin e asortimenteve me mish dhe shpendë (verifikimi i freskisë, pastrimi, larja, prerja, filetimi, coptimi, grirja, rrahja, lardimi, marinimi, dhe përzgjedhja e teknikës së gatimit). – të kryejë etapat e e procesit teknologjik termik për gatimin e asortimenteve me mish dhe shpendë (me zierje, pjekje, skuqje etj.).	

-
- të mbikqyrë procesin teknologjik të përgatitjes së asortimenteve me mish dhe shpendë.
 - të përgatitë asortimente me mish, tipike shqiptare sipas krahinave.
 - të kryejë vlerësimin organo-shqisor të asortimenteve të përgatitura.
 - të prezantojë asortimentet e përgatitura sipas rregullave të estetikës në gatim.
 - të llogarisë koston e asortimenteve me mish dhe shpendë.
 - të zbatojë rregullat e ambalazhimit dhe etiketimit të mishit për ruajtje.
 - të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
 - të inventarizojë mjetet e punës si dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
 - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së asortimenteve të thjeshta me mish dhe shpendë në kuzhinë.
 - të zbatojë procedurat për grumbullimin e yndyrnave të përdorura për riciklim.
 - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti përgatit prodhime gjysmë të gatshme me mish dhe shpendë, si dhe të brendshmet e tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e përgatitjes së prodhimeve gjysmë të gatshme me mish dhe shpendë, si dhe të brendshmet e tyre.
- të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhime gjysmë të gatshme.
- të shpjegojë rëndësinë e etiketimit të prodhimeve gjysmë të gatshme për ruajtje.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të hartojë planin e prodhimit dhe fletë-këskesën.
- të parapërgatitë vendin e punës për përgatitjen e prodhimeve gjysmë të gatshme.
- të lexojë saktë recetën.
- të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen e prodhimeve gjysmë të gatshme.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse, sipas recetës.

- të kryejë procese parapërgatitore për përgatitjen e prodhimeve gjysmë të gatshme (larja, prerja, coptimi, grirja, marinimi etj.).
- të kryejë etapat e përpunimit të ftohtë për përgatitjen e prodhimeve gjysmë të gatshme.
- të përgatitë prodhime gjysmë të gatshme, tipike shqiptare sipas krahinave.
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të prodhimeve gjysmë të gatshme.
- të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe vakumimit të prodhimeve gjysmë të gatshme.
- të monitorojë procesin e ruajtjes të prodhimeve gjysmë të gatshme (në abatitor).
- të llogarisë koston e prodhimeve gjysmë të gatshme.
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
- të inventarizojë mjetet e punës si dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së prodhimeve gjysmë të gatshme në kuzhinë.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përgatit asortimente me të brendshme mishi/ shpendë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kushteve të ruajtjes së lëndëve të para dhe ndihmëse për asortimente me të brendshme mishi/ shpendë.
- të përshkruajë dallimin midis të brendshmeve të mishit sipas llojit të bagëtive dhe të shpendëve.
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës.
- të zbatojë rregulloren e brendshme në kuzhinë;
- të hartojë planin e prodhimit dhe fletë-kërkesën.
- të parapërgatitë vendin e punës për gatimin e asortimenteve me të brendshme mishi/ shpendë.
- të lexojë saktë recetën.
- të përzgjedhë mjetet e punës për përgatitjen për gatimin e asortimenteve me të brendshme mishi/ shpendë.
- të marrë në dorëzim lëndët e para dhe ndihmëse.
- të përzgjedhë lëndët e para dhe ndihmëse sipas recetës.
- të verifojë cilësinë e lëndëve të para (vlerësim organo-shqisor).

- të kryejë procese parapërgatitore për gatimin e asortimenteve me të brendshme mishi/ shpendë (larja, prerja, coptimi, grirja, marinimi, përzgjedhja e metodës së gatimit etj.).
- të kryejë etapat e e procesit teknologjik termi për gatimin e asortimenteve me të brendshme mishi/ shpendë, sipas recetës.
- të mbikqyrë procesin teknologjik për gatimin e asortimenteve me të brendshme mishi/ shpendë.
- të përgatitë asortimente me të brendshme mishi, tipike shqiptare, sipas krahinave.
- të kryejë vlerësimin organo-shqisor të asortimenteve të përgatitura.
- të prezantojë asortimentet sipas rregullave të estetikës në gatim.
- të llogarisë koston e asortimenteve të përgatitura.
- të pastrojë vendin e punës, sistemojë, dezinfektojë dhe mirëmbajë mjetet dhe pajisjet e punës.
- të inventarizojë mjetet e punës si dhe lëndët e para dhe ndihmëse për ruajtje.
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë përgatitjes së asortimenteve me të brendshme mishi në kuzhinë.
- të zbatojë procedurat për grumbullimin e yndyrnave të përdorura për riciklim.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

